The Human Rights Advisory Panel
UNMIK Administrative HQ, Container D, 10000 Pristina, Kosovo

**MENDIM (*)**

**Data e miratimit: 12 nëntor 2008**

**Nr. i lëndës 04/08**

**Shaip CANHASI**

**kundër**

**UNMIK-ut**

Paneli Këshillëdhënës mbi të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 12 nëntor 2008, me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Paul LEMMENS, Kryesues
Znj. Snezhana BOTUSHAROVA,

Z. John J. RYAN, Zyrtar ekzekutiv

Duke ditur tërheqjen e z. Marek NOWICKI nga ky rast në pajtim me Rregullën 12 të Rregullores së Punës,

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës mbi të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit, nxjerr të gjeturat dhe rekomandimet vijuese:

## I. FAKTET E RASTIT

1. Sipas ankuesit, faktet në këtë rast janë si vijon.

2. Më 3 shkurt 2000, rreth 23.00,15 individë me forcë hynë në një banesë në veri të Mitrovicës dhe e vranë gruan e ankuesit (znj. Remzije Canhasi) në prani të ankuesit dhe të një polici të UNMIK-ut, i cili jetonte në banesë si qiraxhi.

(*) Gabimi i zyrës i korrigjuar, në pajtim me Rregullën 47.1 të Rregullores së Punës, më 17 janar 2009.

3. Më 4 shkurt 2000, rreth 00.30, policët e UNMIK-ut e larguan ankuesin dhe policin e UNMIK-ut nga banesa.

4. Më 4 shkurt 2000 Njësia Rajonale e Hetimeve në Mitrovicë (NJRH) së bashku me një ekip të forenzikës e kontrolluan dhe e vërtetuan vendin e krimit dhe siguruan provat.

5. Më 7 shkurt 2000, një patolog nga Instituti i Patologjisë Forenzike në Prishtinë e bëri autopsinë e znj. Canhasi.

6. Ndërmjet 4 dhe 20 shkurtit 2000, NJRH intervistoi disa dëshmitarë të cilët dhanë emrat dhe adresat e katër individëve të cilët ata pohonin se e kishin vrarë znj. Canhasi.

7. Më 11 shtator 2000, Instituti Kërkimor i Kriminalistikës dhe Kriminologjisë në Sofie, Bullgari ekzaminoi provat materiale.

8. Meqë më 29 janar 2002, kur Ombudspersoni në Kosovë i dërgoi një raport Përfaqësuesi Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) mbi çështjen e njëjtë, nuk kishte indikacione se autoritetet kompetente kishin ndërmarrë veprime të mëtejshme që nga 11 shtatori 2000, dhe nuk kishte shënime se individët e identifikuar nga dëshmitarët në shkurt 2000 ishin intervistuar ndonjëherë, Ombudspersoni i dërgoi shkresa përcjellëse më 14 shkurt 2003, 29 prill 2003 dhe 6 maj 2005 Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut, por nuk mori asnjë përgjigje.

9. Paneli bën me dije se faktet ashtu siç janë paraqitur nga ankuesi janë konsistente me raportin e Ombudspersonit dhe nuk janë kundërshtuar nga i padituri.

## II. PROCEDURA PRANË PANELIT

10. Ankesa u paraqit më 15 prill 2008 dhe u regjistrua në ditën e njëjtë.

11. Më 10 qershor 2008 Paneli ia komunikoi ankesën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) në pajtim me nenin 11.3 të Rregullores nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës mbi të Drejtat e Njeriut, duke kërkuar komente mbi pranueshmërinë dhe meritat e ankesës deri më 9 korrik 2008. Paneli gjithashtu kërkoi kopje të cilado vendimeve, të cilët janë marrë gjatë rrjedhës së hetimeve. PSSP-ja nuk paraqiti ndonjë vërejtje deri në datën përkatëse as nuk kërkoi vazhdimin e afatit kohor brenda të cilit do të përgjigjej.

12. Më 15 korrik 2008 Paneli e deklaroi ankesën të pranueshme.

13. Me një shkresë të datës 29 korrik 2008 PSSP-ja ishte informua me vendimin dhe nga ai u kërkua që të përgjigjet në përmbajtjen e ankesës.

14. Më 27 gusht 2008 PSSP-ja paraqiti vërejtjet edhe për pranueshmërinë edhe për meritat e rastit. Panelit nuk i janë siguruar dokumente nga dosja e hetimeve.

15. Ankuesi u përgjigj në pyetjet e PSSP-së përmes një shkrese më 29 tetor 2008.

## III. VËREJTJE PRELIMINARE MBI ÇËSHTJEN E MOSSHTERRIMIT TË MJETEVE JURIDIKE

### A. Argumentet e palëve

16. Në shkresën e tij të datës 27 gusht 2008, i padituri pohonte se ankuesi nuk i kishte shterur mjetet juridike vendore sepse nuk kishte dëshmi se ankuesi i ishte drejtuar Komisionarit të Policisë ose Ministrisë së Punëve të Brendshme për informacione shtesë lidhur me rastin.

17. Ankuesi u përgjigj duke thënë se ai ishte drejtuar disa herë me kërkesa tek Komisionari i Policisë së UNMIK-ut, por që deri më sot nuk kishte marrë asnjë informacion për progresin e hetimeve. Ai gjithashtu tha se ishte drejtuar me kërkesa për informacione tek një organ që tani është nën kompetencë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës. Ai tha se deri më sot asgjë nuk ishte bërë me rastin e tij. Ankuesi gjithashtu bashkëngjiti një numër letrash të cilat Ombudspersoni ia kishte shkruar Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut, duke kërkuar informacione më ët freskëta për hetimin e datës 14 shkurt 2003, 29 prill 2003 dhe 6 maj 2005. Këto kërkesa për informacione gjithashtu mbeten pa përgjigje.

**B. Qasja e Panelit**

18. Palët të cilat kërkojnë të ngrenë çështje të pranueshmërisë pasi të jetë marrë vendimi për pranueshmërinë e ankesës, natyrisht se do të ndalen nga paraqitja e fundit e argumenteve të pranueshmërisë. Por, në këtë rast, nuk është e nevojshme të paraqitet qëndrimi mbi pranueshmërinë e kundërshtimit të palës së paditur, bazuar në mosshterrimin e mjeteve juridike, meqë kjo vërejtje, në cilindo rast, nuk do të ishte e bazuar siç do të shpjegohet më poshtë.

**C. Parimet e përgjithshme**

**i. Baza ligjore për mosshterrimin e mjeteve juridike**

19. Neni 3.1 i Rregullores nr. 2006/12 thotë se Paneli mund të merret me një çështje vetëm pasi të konstatojë se janë ndjekur të gjitha rrugët tjera në dispozicion për rishqyrtimin e shkeljeve të pohuara.

20. Arsyeja e rregullës së mosshterrimit është që autoriteteve kompetente, kryesisht gjykatave, t'u ofrojë mundësinë të parandalojnë apo rregullojnë shkeljet e pohuara të instrumenteve relevante ndërkombëtare. Bazohet në supozimin, të reflektuar në nenin 13 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (më tutje: KEDNJ) dhe dispozitave të ngjashme në traktate, se rendi ligjor vendor do të sigurojë mjete efektive për shkeljet e të drejtave të ankuesve (Gjykata Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (më tutje: GJEDNJ), *Selmouni v. France*, nr. 25803/99, aktgjykimi i 27 korrikut 1999, § 74).

**ii. Disponueshmëria dhe efektiviteti**

21. Nga aplikantët kërkohet që të shterojnë mjetet vendore të cilat i kanë në dispozicion dhe që janë efektive. Mjetet e vetme të cilat kërkohet që të shterohen janë ato që lidhen me shkeljet e pohuara. Ekzistimi i mjeteve të tilla duhet të sigurohet jo vetëm në teori por edhe në praktikë, mungesa e të cilëve do të shkaktojë mungesën e qasjes së kërkuar dhe efektivitetit (GJEDNJ, *Selmouni v. France,* cituar më lart*,* § 76; shih gjithashtu GJEDNJ, *Vernillo v. France*, nr. 11889/85, 20 shkurt 1991, § 27; GJEDNJ, *Akdivar dhe të tjerët v. Turkey*, nr. 21893/93, aktgjykim i 16 shtatorit 1996, § 66; dhe GJEDNJ, *Dalia v. France*, nr. 26102/95, aktgjykim i 19 shkurtit 1998, § 38). Mjetet diskrecionare apo të jashtëzakonshme nuk duhet të shterohen (GJEDNJ, *Prystavka v. Ukraine*, nr. 21287/02, vendim i 17 dhjetorit 2002; ECtHR, *Cinar v. Turkey*, nr. 28602/95, vendim i 13 nëntorit 2003). Në përcaktimin nëse një mjet i caktuar i plotëson kriteret e disponueshmërisë dhe efektivitetit, duket marrë parasysh

rrethanat e veçanta të rastit individual (GJEDNJ, *Van Oosterwijck v. Belgium*, nr. 7654/76, aktgjykim i 6 nëntorit 1980, §§ 36-40; ECtHR, *Khashiyev dhe Akayeva v. Russia*, nos. 57942/00 & 57945/00, aktgjykim i 24 shkurtit 2005, §§ 116-117; GJEDNJ, *Isayeva dhe Others v. Russia*, nos. 57947/00, 57448/00, 57949/00, aktgjykim i 24 shkurtit 2005, §§ 152-153).

**iii. Barra e dëshmisë**

22. Është detyrë e të padituri të pohojë mosshterrimin e mjeteve për të siguruar Panelin se mjeti ishte mjet efektiv, që ekzistonte në teori dhe në praktikë në kohën duhur, d.m.th. se në të ka pasur qasje, ka qenë mjet që ka ofruar kompensim lidhur me ankesat e individit dhe ka ofruar shpresë të arsyeshme për të ardhmen. Me fjalë të tjera, nëse i padituri pohon mosshterrim, e bart barrën e dëshmimit se ankuesi nuk e ka përdorur një mjet i cili ka qenë edhe efikas edhe në dispozicion në kohën përkatëse. I padituri duhet të konstatojë se këto kushte të ndryshme janë plotësuar (ECtHR, *Selmouni v. France*, cituar më lart, § 75).

**D. Vlerësimi i Panelit**

23. Lidhur me vërejtjet e PSSP-së mbi pranueshmërinë, Paneli njofton se i padituri nuk ka ofruar asnjë lloj informacioni pse rrugët e pohuara për rishqyrtim janë mjete të cilat duhet të shterohen dhe pse ato janë mjete efektive (krahaso GJEDNJ, *Vereinigung Demokratischer Soldaten Österreichs dhe Gubi v Austria*, Seria A, nr. 302, aktgjykim i 19 dhjetorit 1994, § 93). Paneli është i mendimit se kërkesa për informacione shtesë për progresin e hetimeve, në këtë rast, nuk përbën 'rrugë në dispozicion për rishqyrtim' për shkeljen e pohuar, që dështimi i pohuar për të kryer hetim adekuat të vrasjes së gruas së ankuesit. Në këtë rast, 'mjeti efektiv' i cili kërkohet nga ankuesi ishte 'hetim i thellë dhe efektiv në gjendje që të shpie në identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës për privimin nga jeta' (GJEDNJ., *Keenan v. United Kingdom*, nr. 21987/93, aktgjykim i 3 prillit 2001, § 122), që thjesht nuk është informacion që do të konfirmonte se hetimet kishin ngecur, siç duket që nga 11 shtatori 2000.

24. Në çdo rast, Paneli thekson se ankuesi i është drejtuar Komisionerit të Policisë së UNMIK-ut disa herë si dhe agjencive qeveritare brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës. Ombudspersoni miratoi një raport për këtë çështje më 29 janar 2002 dhe i dërgoi tri letra përcjellëse Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut (shih paragrafin 8 lart) pa marrë përgjigje në kërkesën e tij për përditësim të mëtejshëm mbi hetimet.

25. Së këndejmi, Paneli e hedhë poshtë vërejtjen e të padituri lidhur me mosshterrimin e mjeteve.

**IV. SHKELJA E POHUAR E NENIT 2 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

**A. Ankesa**

26. Pala ankuese pohon se nuk janë ndërmarrë masa të përshtatshme në mënyrë që në mënyrë të duhur të hetohet vrasja e gruas së tij, prandaj edhe pohon se është shkelur procedura, e cila kërkon hetimin e humbjes së jetës sipas nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

**B. Parimet e përgjithshme**

27. Neni 2 i KEDNJ, i cili ruan të drejtën në jetë, renditet si njëra prej dispozitave më themelore të KEDNJ,dhe ruan një nga vlerat më themelore të shoqërive demokratike. Pohimet për shkeljen e kësaj dispozite do t'i nënshtrohen një analize të hollësishme nga ana e Panelit (shih GJEDNJ, *Nachova and Others v. Bulgaria*, no. 43577/98 & 43579/98, vendim i datës 6 korrik 2005, § 93; ECtHR, *Angelova and Illiev v. Bulgaria*, no. 55523/00, vendim i datës 26 korrik 2007, § 91).

28. Obligimi për të mbrojtur të drejtën në jetë sipas nenit 2 të KEDNJ, interpretohet në lidhje me detyrën e përgjithshme të shtetit sipas nenit 1 të KEDNJ,që "t'i sigurohen çdokujt brenda juridiksionit [të vetë] të drejtat dhe liritë e përcaktuara në [këtë] Konventë", gjithashtu sipas nënkuptimit kërkon që duhet të ketë një lloj i formës efektive të hetimit zyrtar për rastet kur individët janë vrarë si pasojë e përdorimit të forcës (shih, GJEDNJ, *McCann and Others v. United Kingdom*, no. 18984/91, vendim i datës 27 shtator 1995, § 161; GJEDNJ, *Kaya v. Turkey, Reports* 1998-I, p. 324, vendim i datës 19 shkurt 1998, § 86; GJEDNJ, *Kelly v. the United Kingdom*, no. 30054, vendim i datës 4 maj 2001, §§ 94-98; shih po ashtu Human Rights Advisory Panel (tutje HRAP), *Balaj dhe të tjerët*, nr. 04/07, vendimi mbi pranueshmërinë, i datës 6 qershor 2008, § 14).

29. Paneli thekson se, obligimi i përmendur procedural sipas nenit 2 nuk kufizohet për rastet e përfshirjes aktive të shtetit në një vrasje, por ka një shtrirje autonome më të gjerë (GJEDNJ, *Šilih v. Slovenia*, no. 71463/01, vendim i datës 28 qershor 2007, § 94; shih po ashtu ECtHR, *Yasa v. Turkey*, no. 22495/93, vendim i datës 2 shtator 1998, § 100; GJEDNJ, *Menson v. United Kingdom*, no. 47916/99, vendim mbi pranueshmërinë i datës 6 maj 2003, § 1). Në *Angelova and Iliev v. Bulgaria*, të përmendur lart, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) konsideron se:

> 92… "Prandaj rasti aktual duhet të ndahet prej rasteve të cilat përfshijnë përdorimin e forcës vdekjeprurëse qoftë nga agjentët e shtetit ose nga palët private në marrëveshjen e tyre të fshehtë (shih *McCann dhe të tjerët v. the United Kingdom*, vendim i datës 27 shtator 1995, Series A no. 324; *Shanaghan v. the United Kingdom*, no. 37715/97, § 90, 4 maj 2001; *Anguelova v. Bulgaria*, no. 38361/97, ECHR 2002-IV; *Nachova dhe të tjerët*, të përmendur më lart; dhe *Ognyanova dhe Choban v. Bulgaria*, no. 46317/99, 23 shkurt 2006), ose në të cilin rrethanat faktike kanë imponuar një obligim për autoritetet për të mbrojtur jetën e një individi, për shembull, aty ku ata kanë marrë përgjegjësinë për mirëqenien e tij (shih *Paul and Audrey Edwards v. the United Kingdom*, no. 46477/99, KEDNJ 2002-II) ose kur kanë ditur apo është dashur të dinë se jeta e individit është në rrezik (shih *Osman v. the United Kingdom*, vendim i datës 28 tetor 1998, *Reports of Judgments and Decisions* 1998-VIII).
> 93. Mirëpo, mungesa e ndonjë përgjegjësie direkte të shtetit për vdekjen e familjarit të palës ankuese nuk përjashton aplikueshmërinë e nenit 2 të Konventës. Gjykata përsëritë se duke kërkuar që shteti të ndërmerr hapa të përshtatshëm për të ruajtur jetën e personave që gjenden nën juridiksionin e vet. (shih *L.C.B. v. the United Kingdom*, vendim i datës 9 qershor 1998, *Raportet* 1998-III, p. 1403, § 36), neni 2 § 1 i Konventës, e ngarkon me detyrë atë shtet që të sigurojë të drejtën në jetë përmes vendosjes efektive të dispozitave të ligjit penal për të përmbajtur shkaktimin e shkeljeve kundër personit, duke e mbështetur me makinerinë për zbatimin e ligjit për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin për shkelje të dispozitave të tilla (shih *Osman*, përmendur më lart, § 115).

94. Gjykata përsëritë se, në rrethanat e rastit aktual ky obligim kërkon që të ketë një formë e hetimit zyrtar kur ekzistojnë arsye për të besuar se një individ ka shkaktuar lëndime që kërcënojnë jetën në rrethana të dyshimta. Hetimi duhet të jetë në gjendje që të konstatojë shkakun e lëndimeve dhe identifikimin e atyre që janë përgjegjës në kuptim të ndëshkimit të tyre. Aty ku për pasojë shkaktohet vdekja, sikurse në këtë rast, hetimi pretendon rëndësi edhe më të madhe, duke pasur parasysh faktin se qëllimi esencial i një hetimi të tillë është që të sigurohet zbatimi i ligjeve të vendit, të cilat mbrojnë të drejtën në jetë (shih *Anguelova*, të përmendur më lart, § 137; *Nachova and Others*, të përmendur më lart, § 110; dhe *Ognyanova and Choban,* të përmendur më lart*,* § 103), …"

30. Obligimi për të hetuar nuk varet nga përfundimi, por nga mjetet e përdorura. Autoritetet është dashur të ndërmarrin hapa të arsyeshëm të cilët janë në dispozicion të tyre për sigurimin e dëshmive lidhur me incidentin, duke përfshirë, në mes tjerash deklaratën e dëshmitarit (GJEDNJ, *Kelly v. United Kingdom*, të përmendur më lart, §§ 94-98; GJEDNJ, *Orhan v. Turkey,* no. 25656/94, 18 June 2002, § 92) dhe dëshmitë nga dëshmitarë kyç të tjerë (GJEDNJ, *Önen v. Turkey*, no. 22876/93, vendim i datës 14 maj 2002, § 88; GJEDNJ, *Tahsin Acar v. Turkey*, no. 26307/95, vendim i datës 8 pril 2004, §§ 230-232). Aty ku ka diçka të besueshme ose kredibile, pohim, pjesë të dëshmisë ose një pjesë e informacionit që është me rëndësi për identifikimin dhe eventualisht ndjekjen ose ndëshkimin e kryesit të veprës së vrasjes së paligjshme, autoritetet kanë për obligim që të ndërmarrin masa të mëtejme hetimore (GJEDNJ, *Brecknell v. United Kingdom*, no. 32457/04, vendim i datës 27 nëntor 2007, §§ 71, 75). Çfarëdo pamjaftueshmërie e hetimit, e cila rrënon mundësinë e hetimit për të konstatuar shkakun e vdekjes ose identifikuar personin ose personat përgjegjës, rrezikon të shkaktojë parregullësi të këtij standardi (GJEDNJ, *Nachova and Others v. Bulgaria*, të përmendur më lart, § 113; GJEDNJ, *Ognyanova and Choban,* të përmendur më lart*,* § 105; GJEDNJ, *Angelova and Iliev v. Bulgaria*, të përmendur më lart, § 95; HRAP, *Balaj and others*, të përmendur më lart, §14).

31. Një aspekt i mëtejm i një hetimi joadekuat paraqet një element të mjaftueshëm të shqyrtimit të hollësishëm publik të hetimit ose të rezultateve të tij për të siguruar llogaridhënie, si në praktikë ashtu edhe në teori. Shkalla of shqyrtimit të hollësishëm publik, gjithashtu mund të ndryshojë varësisht prej rastit. Sidoqoftë, në të gjitha rastet, të afërmit e viktimës duhet të përfshihen në procedurë deri në masën që është e domosdoshme për të ruajtur interesat legjitime të tij/saj (GJEDNJ, *Hugh Jordan v. United Kingdom*, no. 24746/94, vendim i datës 4 gusht 2001, § 109; GJEDNJ, *Finucane v. United Kingdom,* no. 29178/95, vendim i datës 1 korrik 2003, § 71).

32. Në mënyrë që një hetim të jetë në pajtim me kërkesat nga neni 2, ai duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i cili demonstron përparim të vërtetë gjatë zhvillimit të hetimit (ECtHR, *Yasa v. Turkey*, të përmendur më lart § 100). Çfarëdo periodash të gjata kohore të mosaktivitetit lidhur me rastin mund të jenë tregues të një dështimi për një vazhdim të efektshëm të hetimit me qëllim të identifikimit të kryerësve të veprës (shih për shembull ECtHR, *Takhayeva v. Russia*, no. 23286/04, vendim i datës 18 shtator 2008, § 93).

33. Paneli kujton nevojën për mosinterpretim të obligimit pozitiv për të zhvilluar një hetim në atë mënyrë, e cila do të impononte një ngarkesë të pamundshme ose shpërputhëse për autoritetet, duke pasur parasysh vështirësitë në kryerjen e detyrave policore në shoqëritë moderne dhe ndërgjegjen e zgjedhjes operacionale të vështirë në kuptim të prioriteteve dhe burimeve (GJEDNJ, *Osman v. United*

*Kingdom*, të përmendur më lart, § 116; GJEDNJ, *Akdoğdu v. Turkey*, no. 46747/99, vendim i datës 18 tetor 2005, § 45; GJEDNJ, *Dodov v. Bulgaria*, no. 59548/00, vendim i datës 17 janar 2008, § 102; GJEDNJ, *Albekov v. Russia*, no. 68216/01, vendim i datës 9 tetor 2008, §79). Mirëpo, edhe në rast të ekzistimit të pengesave ose vështirësive, të cilat e pengojnë progresin gjatë një hetimi në një situatë të caktuar, një përgjigje e shpejtë e autoriteteve është vitale për ruajtjen e besimit në publik për zbatimin e sundimit të ligjit dhe për parandalimin e çfarëdo paraqitjeje që është në konflikt ose që toleron veprime të paligjshme (GJEDNJ, *Brecknell v. United Kingdom*, të përmendur më lart, § 65; GJEDNJ, *McKerr v. United Kingdom*, no. 28883/95, vendim i datës 4 maj 2001, §§ 111, 114). Në këto rrethana Paneli duhet të sigurohet se autoritetet kanë bërë mjaft në përmbushjen e obligimit të tyre për zhvillim të një hetimi efektiv për këtë rast.

**C. Aplikushmëria për rastin aktual**

34. Nëse autoritetet kanë një obligim pozitiv për të siguruar pajtueshmëri me standardet relevante për të drejtat e njeriut, si bie fjala, kërkesa për të zhvilluar një hetim të plotë dhe efektiv në bazë të nenit 2 të KEDNJ, atëherë u përket autoriteteve që të demonstrojnë se ato kanë ndërmarrë hapa të arsyeshëm për përmbushjen e obligimeve të veta pozitive. Për këtë rast, që nga data 11 shtator 2000 nuk është siguruar asnjë informacion për të treguar se janë ndërmarrë hapa për të përparuar me hetimin. Prandaj, Paneli duhet të vlerësojë efektshmërinë e hetimit në bazë të informacionit të paraqitur nga pala ankuese duke përfshirë edhe raportin e Ombudspersonit lidhur me këtë çështje, të krahasuar me mungesën e informacionit lidhur me progresin e hetimit të paraqitur nga i padituri (krahaso, për shembull, GJEDNJ, *Takhayeva v. Russia*, të përmendur më lart, § 89).

35. Paneli pranon se nga i padituri është kryer autopsia dhe ekzaminimi forenzik, duke përfshirë hetimin e vendit të ngjarjes. Mirëpo, nuk ka ndonjë tregues se deklaratat ishin marrë nga të gjithë dëshmitarët relevant, duke përfshirë edhe dëshmitarët okularë. Dëshmitë sugjerojnë se dëshmitarët e intervistuar nga policia kanë siguruar emrat dhe adresat e një numri të individëve për të cilët pohohet se janë të involvuar në vrasjen e zonjës Canhasi, por nuk ka dëshmi me të cilat do të tregohej se prej këtyre individëve ishin marrë deklaratat, ose që janë bërë përpjekje për marrjen e deklaratave. Paneli nuk ka në disponim ndonjë dëshmi tjetër e cila do të demonstronte përpjekjet e arsyeshme që janë bërë për identifikimin e kryerësve të veprës. Përkundër identifikimit të qartë të të dyshuarve të mundshëm, hetimi është lënë në pritje për tetë vjet duke mos arritur ndonjë rezultat substancial (krahaso, për shembull, ECtHR, *Isaak v. Turkey*, no. 44587/98, vendim i datës 24 qershor 2008, § 124). Më tutje, nuk ka ndonjë informacion në dispozicion për Panelin me të cilin do të demostrohej se prej muajit shtator të vitit 2000 dhe gjatë një periudhe kohore prej tetë vjetëve ishin bërë përpjekje për vazhdim të hetimeve për vrasjen e shkaktuar.

36. Një mungesë tjetër e hetimit është mosinformimi dhe mospërfshirja lidhur me procesin hetimor të të afërmve të viktimës, domethënë e palës ankuese. Përkundër kërkesave të përsëritura për informacion rreth hetimit, pala ankuese nuk ishte informuar. Ai qartazi nuk ka pasur qasje në hetim, ose në ndonjë shpjegim për mos marrjen e deklaratave prej personave për të cilët ishte pohuar se kanë qenë të involvuar në këtë krim.

37. Në këto rrethana Paneli konstaton se autoritetet nuk kanë kryer një hetim efektiv lidhur me rrethanat që kanë të bëjnë me vrasjen e zonjës Canhasi. Hetimet të cilat kërkohen sipas nenit 2 të KEDNJ duhet të jenë në gjendje dhe të shkojnë drejt identifikimit dhe ndëshkimit të atyre të cilët janë përgjegjës. (GJEDNJ, *Bazorkina v.*

*Russia*, no. 69481/01, vendim i datës 27 korrik 2006, § 117). Kjo kërkesë nuk është plotësuar në këtë rast.

38. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se është shkelur aspekti procedural i nenit 2.

**V. REKOMANDIMET**

39. Në dritën e gjetjeve të Panelit për këtë rast, Paneli është i mendimit se një lloj i riparimit është i domosdoshëm. Ai rekomandon që i padituri të ndërmerr masat si vijon:

- i padituri duhet me kujdes të ndërmerr masa efektive për identifikimin e autorëve të krimit. Masat e tilla efektive duhet të përfshijnë ndërmarrjen e të gjithë hapave për t'u siguruar që deklaratat të merren nga dëshmitarët relevant dhe të bëhet një rishikim gjithëpërfshirës i hetimit në mënyrë që të përcaktohet se cilët hapa të mëtejmë do të mund ndërmerreshin me qëllim të identifikimit të autorëve të krimit dhe sjelljen e tyre përpara drejtësisë;

- i padituri duhet të bëj një kompensim adekuat për vuajtjen e shkaktuar lidhur me hetimin joadekuat të vrasjes së bashkëshortes së tij

-i padituri duhet të ndërmerr masa të menjëhershme dhe efektive për zbatimin e rekomandimeve të paraqitura në Mendimin e Panelit, duke përfshirë një informim të plotë për palën ankuese dhe Panelin për zhvillimet e mëtejme të këtij rasti.

**PËR KËTO ARSYE,**

Paneli, unanimisht,

**- REFUZON KUNDËRSHTIMIN E TË PADITURIT PËR MOS-SHTERIMIN E MJETEVE LIGJORE TË VENDIT;**

**- KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 2 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË LIDHJE ME DËSHTIMIN E ZHVILLIMIT TË NJË HETIMI EFEKTIV MBI RRETHANAT NË TË CILAT ISHTE VRARË BASHKËSHORTJA E Z. SHAIP CANHASI-T ;**

**- REKOMANDON QË I PADITURI TË NDËRMERR MASAT E PARAQITURA NË PARAGRAFIN 39 TË KËTIJ MENDIMI PËR RIPARIMIN E PASOJAVE TË SHKELJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT TË PALËS ANKUESE.**

John J. RYAN
Zyrtar ekzekutiv

Paul LEMMENS
Kryesues